



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient Inspektorat dhe Emergjencë

Nr. 03 datë: 15.01.2026



NJOFTIM ZYRTAR

PËR RIHAPJEN E KANALIT ATMOSFERIK DHE RIKTHIMIN NË GJENDJE TË PARË

Të nderuar qytetarë dhe pronarë të bizneseve në fshatin Koretin,

Në mbështetje të raporteve teknike të komisioneve vlerësuese komunale dhe planeve për parandalimin e vërshimeve, Komuna e Kamenicës njofton opinionin publik se do të ndërmarrë masa emergjente për rihapjen e kanalit të ujërave atmosferikë në anën perëndimore Koretin në rrugën “Rafet Isufi”.

Ky vendim vjen si pasojë e analizës së dëmeve të përsëritura nga vërshimet, të cilat kanë konstatuar se:

1. Mbyllja e kanalit ka shkaktuar pengesa në rrjedhën natyrale të ujërave, duke rrezikuar drejtpërdrejt infrastrukturën rrugore dhe sigurinë në komunikacion.
2. Ndërhyrjet e paautorizuara mbi kanalën atmosferik kanë cenuar kushtet e banimit dhe sigurinë e pronës për shumë familje të zonës.

Kërkojmë nga të gjithë pronarët e parcelave përgjatë rrugës “Rafet Isufi” (ana perëndimore) që:

Të lirojnë hapësirën e kanalit duke larguar çdo lloj investimi, rrethoje, objekte montuese apo material tjetër që pengon funksionalizimin e tij. Ky proces duhet të përfundojë më së largu deri më datë **31 mars 2026**.

Pas kalimit të këtij afati, Komuna e Kamenicës përmes Drejtorive përkatëse do të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm. Çdo kosto e ndërhyrjes nga organet komunale për largimin e pengesave do të bartet nga vetë palët, konform legjislacionit në fuqi.

Ky projekt është në interes të përgjithshëm të komunitetit dhe synon mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve tanë.

Ju faleminderit për bashkëpunim!



